STUDIM RASTI:
“Vermin,” “Parazitë,” “Satan”: Si u bë gjuha toksike një pjesë normale e diskursit publik

Institute of Communication Studies

НЕ ВЕРУВАЈ ПРОВЕРУВАЈ! #користифакти

STUDIM RASTI: “Vermin,” “Parazitë,” “Satan”: Si u bë gjuha toksike një pjesë normale e diskursit publik

Diskursi toksik në peizazhin politik online të Maqedonisë së Veriut vazhdon të lulëzojë, i ushqyer edhe nga polarizimi i mprehtë dhe anonimiteti i mediave sociale. Midis datës 29 shtator dhe 22 dhjetor 2024, platforma EOOH kishte monitoruar gjithsej 238 postime (n=238), duke identifikuar fakte mbi gjuhën e urrejtjes drejtuar figurave dhe grupeve politike.

Hulumtimi, i kryer nga Instituti i Studimeve të Komunikimit (ICS) në bashkëpunim me Textgain, kishte për synim të vlerësonte nivelet e gjuhës së dëmshme dhe toksike drejtuar figurave politike në rrjetet sociale Facebook, X (Twitter) dhe TikTok.

Gjetjet kryesore

1. **Platformat dhe toksiciteti**
    - **Facebook:** Mbizotëronte grupi i të dhënave, por janë shfaqur nivele të ndryshme toksiciteti. Gjuha toksike shfaqej shpesh në seksionet e komenteve të postimeve të kandidatëve politikë.
    - **TikTok:** Pavarësisht se kontribuoi vetëm me 1% të totalit të postimeve, ai shfaqi përqindjen më të lartë të mesazheve toksike.

2. **Shembujt e gjuhës toksike**
    - Sulme personale ndaj kandidatëve:

      Nën një postim në Facebook të Presidentes Gordana Siljanovska Davkova që përkujton Ditën e Revolucionit Maqedonas më 23 tetor 2024, komentet përfshinin:

- *"Fikus Pendarovski"* (një term që nënçmon ish-presidentin Stevo Pendarovski si një figurë dekorative pa ndikim).
- *"Marionetë"* (kukull), duke nënkuptuar mungesë agjenturore në vendimmarrje për kryetaren Gordana Siljanovska Davkova.

Po kështu, nën një postim në Facebook të TV Kanal 5 më 26 tetor 2024, janë shfaqur disa komente toksike:

- *"E keqja maqedonase"*, një referencë nënçmuese që kishte për target VMRO-DPMNE-në.
- "Dëgjo ti Micko kafshë" (Listen Micko, you cattle), drejtuar asaj dhe udhëheqjes së partisë së saj.

- **Retorikë çnjerëzore:**

  Terma si *gomar, plehër* dhe *parazitë* u shfaqën nëpër platforma, shpesh që synonin grupet politike ose drejtuesit e tyre. Një shembull tjetër është fraza *satan (djalli)* e përdorur për të dehumanizuar ish-partinë politike në pushtet, LSDM (*"Ju jeni djalli"*).

- **Referenca për dhunë dhe luftë:**

  Komentet që përdorin terma të tillë si *vrasje* dhe *kërcënim* ishin më të zakonshme në TikTok sesa platformat e tjera, duke treguar një shkallë më të lartë armiqësie midis përdoruesve të platformës. Megjithëse, kampioni përfaqësues për TikTok ishte shumë më i ulët se platformat e tjera (me 1% të postimeve të përgjithshme të zbuluara).

3. **Modelet dhe temat**

- **Armiqësi e normalizuar politike:** Fraza si *Zajko*, një fjalë zvogëluese/dimunitiv e përdorur për talljen e ish-kryeministrit Zoran Zaev, *banditë, okupatorë, gomar* dhe *sulm* u shfaqën vazhdimisht në postime, duke treguar se si armiqësia është e rrënjosur në diskursin politik.

Metodologjia

Procesi i mbledhjes së të dhënave u mbështet në platformën në internet të gjuhës së urrejtjes EOOH në bashkëpunim me Textgain, i cili monitoronte ndërveprimet kryesisht në Facebook dhe X (Twitter). Për analizë janë përzgjedhur gjithsej 238 mesazhe. Këto mesazhe u mblodhën nga seksionet e komenteve dhe jo nga postimet zyrtare të bëra nga partitë politike apo vetë kandidatët, duke siguruar një fokus në diskursin publik. Platforma përdori mjete të automatizuara, të shoqëruara edhe nga mbikëqyrja njerëzore, për të nxjerrë mesazhe përkatëse që përfshinin elementë toksikë. Këta elementë u identifikuan në bazë të kategorive të paracaktuara si fyerje, tallje, përbuzje, racizëm, seksizëm, politikë, fe, kërcënime dhe të pavërteta.

Postimet u mblodhën nga Facebook (97%), X (3%) dhe TikTok (1%) dhe u analizuan për rezultatet e toksicitetit dhe përmbajtjen tematike. Të gjitha postimet ishin të shkruara në gjuhën maqedonase, me notë mesatare të toksicitetit prej 0.08. Ndërsa asnjë postim nuk e kaloi rezultatin e toksicitetit prej 0.8, fjalët kyçe dhe temat e përsëritura theksuan armiqësinë sistematike në bisedat/diskutimet në internet.

Analiza përfshinte mjete të automatizuara gjuhësore dhe mbikëqyrje njerëzore për të identifikuar vulgaritetin, kërcënimet dhe gjuhën e urrejtjes me prapavijë politike.

Diskutim

Shembujt e mësipërm theksojnë normalizimin shqetësues të gjuhës së urrejtjes në dialogun politik maqedonas. Përdorimi i shpeshtë i termave si *Fikus Pendarovski* ose *VmroGnidi* ilustron se si gjuha toksike minon debatin kuptimplotë duke u fokusuar në sulme personale dhe jo në politikë.

Në mënyrë të ngjashme, përdorimi i gjuhës së dhunshme dhe çnjerëzore si *vrasja* dhe *parazitët* dhe *satana (djalli)* - jo vetëm që poshtëron kundërshtarët, por gjithashtu rrezikon të nxisë armiqësi në ndërveprimet në botën reale. Këto tendenca gërryejnë cilësinë e diskursit publik, duke zëvendësuar dialogun konstruktiv me armiqësinë dhe polarizimin.

TikTok, pavarësisht se është një platformë më e vogël në këtë kontekst, u shfaq si një pikë e nxehtë e dukshme për mesazhet me toksicitet të lartë. Përforcimi algoritmik i përmbajtjes së tij mund të përkeqësojë përhapjen e postimeve inflamatore, duke polarizuar më tej përdoruesit.

Përfundim

Ky studim rasti nënvizon natyrën e përhapur të gjuhës së urrejtjes politike në Maqedoninë e Veriut. Përdorimi i fyerjeve të synuara si *Fikus Pendarovski* dhe *VmroGnidi* zbulon se si personazhet publike dehumanizohen në mënyrë rutinore në internet, duke minuar besueshmërinë e tyre dhe duke dekurajuar angazhimin qytetar.

Kategoritë e analizuara toksike

Elementët e mëposhtëm toksikë u shqyrtuan në kontekstin e mesazheve drejtuar kandidatëve presidencialë:

- **Vulgariteti:** Përdorimi i gjuhës vulgare që synon poshtërimin e kandidatëve.
- **Talljet:** Komentet që synojnë të tallen me kandidatët, shpesh bazuar në gjininë ose moshën e tyre.
- **Përbuzjet:** Shprehje përbuzjeje ose mosrespektimi, shpesh të lidhura me karakteristika politike ose personale.

- **Racizmi:** Edhe pse më pak i zakonshëm, mesazhe të caktuara përmbanin sharje ose referenca etnike.
- **Seksizmi:** fyerje ose komente gjinore që synojnë minimin e kandidatëve për shkak të gjinisë së tyre.
- **Politika:** Fyerje me prapavijë politike, shpesh të lidhura me përkatësitë e partive VMRO-DPMNE ose LSDM.
- **Feja:** Referencat ndaj fesë në një kontekst nënçmues ose poshtërues.
- **Kërcënimet:** Mesazhe që përmbajnë dhunë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptuar.
- **Të pavërtetat:** Dezinformata ose pretendime të rreme për kandidatët.

Institute of Communication Studies

НЕ ВЕРУВАЈ ПРОВЕРУВАЈ! #користифакти